

RENDITJA E KANDIDATËVE NË HYRJE SIPAS GRUPEVE DHE RREGULLAT QË DUHEN ZBATUAR

Të nderuar Maturantë Shqiptarë, bazuar mbi rregulloren e konkursit, ju duhet të respektoni rigorozisht rregullat listuar më poshtë:

- Konkursi/Testi i pranimi zhvillohet në datën 19 Gusht 2026, salla e Pallatit të Kongreseve, Tiranë.
- Hyrja për në sallë fillon në orën 10:00, sipas renditjes në grupe (grupet i gjeni bashkëlidhur njoftimit).
- Duhet të keni me vete vetëm mjetin e identifikimit (Kartë Identiteti ose Pasaportë), në rast të kundërt nuk do të lejohet hyrja.
- Në sallën e testimit, kandidati qëndron në vendin që i caktohet. Ky vend është i pandryshueshëm gjatë gjithë testimit.
- Mbi tavolinë kandidati vendos dokumentin e identitetit (kartë identiteti ose pasaportë).
- Në rast konstatimi të një personi të futur për një tjetër me dokumente identifikuese të testit, kandidati humbet përgjithmonë të drejtën për pranimin në një nga degët që ofron FAU, Universiteti Politeknik i Tiranës.
- Nevojat personale duhet të kryehen përpara fillimit të testit.
- Testimi është individual. Nuk lejohet asnjë komunikim mes njeri-tjetrit.
- Pas dhënies së testit nuk lejohet asnjë sqarim lidhur me përmbajtjen ose me zgjidhjen e tij. Gjithçka të nevojshme kandidati do ta gjejë në test nëpërmjet formimit të pyetjeve të tij.
- Nga momenti i hapjes së tezës, provimi zgjat 2 (dy orë).
- Përmbajtja e testit nuk duhet të kopjohet, fotografohet ose riprodhohet.
- Në rast konstatimi të kopjimit, kandidati humbet përgjithmonë të drejtën e pranimi në një nga degët e UPT.
- Ndalohet kategorikisht të bëhen shënime ose shenja të çfarëdo natyre në fletën e përgjigjeve të testit ose mbi barkodin e sekretimit. Kur shënimi vlerësohet si shenjë dalluese, Komisioni i Vlerësimit e s’kualifikon testin. Shënimet lejohen vetëm në fletët e pyetjeve.
- Nuk lejohet kategorikisht përdorimi i telefonave celularë, mjeteve audio-vizuale, aparateve fotografike, etj.
- Pjesëmarrësit në konkurs nuk kanë nevojë të marrin me vete asnjë mjet për të shkruar apo vizatuar.
- FAU do të pajisë cdo maturantë me një stilolaps dhe një shishe ujë.
- Largimi nga testimi lejohet vetëm pasi të jenë kryer procedurat e verifikimit të kandidatit dhe sekretimi i dokumentacionit të tij.
- Kandidati që përfundon testimin detyrimisht duhet të dorëzojë testin me sekretimin bashkëngjitur dhe të nënshkruajë në një listë emërore përkatëse.

Shkelja e rregullave të mësipërme, çon në s’kualifikimin e kandidatit.

Shënim

Asnjë aplikant nuk do të lejohet të marrë pjesë në testin e pranimi nëse nuk është regjistruar më parë dhe nuk ka emrin në listë ([Shiko listën e të regjistruarve](#)).